

| | | | |
|---|-------|---------|-------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY | | | |
| PRANUAR | | 13/12/ | 2024 |
| Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera |
| 01-030/01- | 593 | 13 | |



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS



Zyra e Kryetarit

Drenas, 11 dhjetor 2024

Për: KKSB-në

Lënda: Plani i punës për vitin 2025 i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi funksionon duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi. Sipas këtij udhëzimi puna e KKSB-së duhet bazohet gjithmonë në dispozitat që rregullojnë çështjen e funksionimit si një organ këshillues për çështjet e sigurisë në bashkësi me përfaqësim të gjerë të gjitha komuniteteve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile.

Plani i mëposhtëm përfshin objektivat kryesore, aktivitetet, bartësit e aktiviteteve, dhe afatet kohore.

Qëllimi i planit është përmirësimi i sigurisë publike dhe ndërtimi i një komuniteti më të sigurtë si dhe rritja e bashkëpunimit mes institucioneve, qytetarëve dhe palëve të interesuara për sigurinë në komunitet.

PLANI I PUNËS SË KKSb-SË PËR VITIN 2025

| Nr. rendor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit |
|------------|---|--|---------------------------|---|
| 1. | Rritja e vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal | <ul style="list-style-type: none"> ➤ Fushata Informuese ➤ Takime dhe diskutime me komunitetin ➤ Programet Edukative në Shkolla ➤ Angazhimi i autoriteteve dhe institucioneve lokale ➤ Aktivitete tjera ndërgjegjësuese | Janar-Dhjetor 2025 | KKSb/KLSP/ZBGJ/OJQ/Drejtoritë komunale |
| 2. | Identifikimi i brengave lidhur me sigurinë publike | <ul style="list-style-type: none"> ➤ Mbledhja e të dhënave nga burimet e ndryshme ➤ Organizimi i takimeve të rregullta ➤ Inspektimi dhe vlerësimi i gjendjes në terren, pra të infrastrukturës publike ➤ Bashkëpunimi me akterë tjerë të sigurisë si Policia dhe Institucionet e Zbatimit të Ligjit, Institucionet arsimore dhe Organizatat Rinore; Organizatat joqeveritar dhe fetare | Janar-Dhjetor 2025 | KKSb/KLSP/ZBGJ/OJQ Drejtoritë komunale |

| | | | | |
|----|---|---|-------------------------------|---|
| 3. | Rekomandimi i planeve të veprimit dhe adresimi i brengave të qytetarëve te autoritetet komunale | <ul style="list-style-type: none"> ➤ Mbledhjet e KKSB-së ➤ Mbledhjet e KLSP-së ➤ Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve ➤ Mbledhjet e Kuvendit Komunal | Janar-Dhjetor 2025 | KSB/KLSP/ZBGJ/ OJQ/Drejtoritë komunale |
| 4. | Ndërtimi i besimit në mes të policisë dhe qytetarëve nëpërmjet ndërtimit të partneritetit dhe iniciativave të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në çdo bashkësi | <ul style="list-style-type: none"> ➤ Takime të rregullta komunitare ➤ Përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje ➤ Iniciativa të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve ➤ Programe për forcimin e partneritetit ➤ Përdorimi i teknologjisë për të ndërtuar besimin ➤ Aktivitete të përbashkët me organizatat në Drenas | Janar-Dhjetor 2025 | KSB/KLSP/ZBGJ/OJQ /Drejtoritë komunale |

| | | | | |
|----|---|--|-------------------------------|---|
| 5. | Përfaqësimi i pikëpamjeve dhe shqetësimeve të të gjithë qytetarëve, për çështjet e krimit dhe për çështjet tjera që lidhen me kualitetin e jetës | <ul style="list-style-type: none"> ➤ Përfshirja e të gjithë grupeve të komunitetit ➤ Organizimi i forumeve dhe platformave të hapura ➤ Promovimi i përfaqësimit të barabartë ➤ Përfshirja e qytetarëve në zgjidhjen e problemeve | Janar-Dhjetor 2025 | KSB/KLSP/ZBGJ/ OJQ/Drejtoritë komunale |
|----|---|--|-------------------------------|---|



Kryetar i Komunës

Ramiz Mladrovci